



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.33/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse në çështjen penale kundër të pandehurit I. K., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 2. dhe nenin 31 të KPRK dhe të pandehurit A. D., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PPPS.nr.60/22 të datës 02.12.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, PN.1.S.nr.186/2022 të datës 29.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.01.2023, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve I. K. dhe A. D., të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PPPS.nr.60/22 të datës 02.12.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, PN.1.S.nr.186/2022 të datës 29.12.2022.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktvendimin PPPS.nr.60/22 e datës 02.12.2022, të pandehurve: S. K., P. K. dhe I. K., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 3.

lidhur me paragrafin 2. dhe lidhur me nenin 31 të KPRK, S. K., L. B. dhe S. G., për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 331, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. dhe nenin 31 të KPRK, S. G., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267, paragrafi 1. lidhur me nenin 31 të KPRK, L. B. për shkak të veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 1. të KPRK, sulmi nga neni 184, paragrafi 1. të KPRK, fajdeja nga neni 331, paragrafi 1. të KPRK, detyrimi nga neni 328, paragrafi 1. të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK, V. T., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK, B. K. dhe D. K., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. lidhur me nenin 31 të KPRK, B. K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK, A. G., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK, A. D., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK, H. Xh., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK, A. S., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK dhe E. G., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, paragrafi 2. të KPRK, iu ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t'iu llogaritet nga data 05.12.2022 e deri me datën 05.02.2023. Të pandehurve paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 187, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1., e 1.2., pika 1.2.1., 1.2.2. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN.1.S.nr.186/2022 e datës 29.12.2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të pandehurve dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit I. K., avokati Durim Osmani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i prishë aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit ose t'i caktohen ndonjë masë më e butë dhe

- mbrojtësi i të pandehurit A. D., avokati Feim Alaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me

propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i prishë aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit ose t'i caktohen ndonjë masë më e butë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.13/23 e datës 27.01.2023, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilat janë identike, mbrojtësit theksojnë se masa e paraburgimit është një nga format më të ashpra të kufizimit të së drejtës së lirisë dhe sigurisë, të garantuara me nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 5, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), se masa e paraburgimit kufizon në mënyrë radikale të drejtën e lirisë dhe sigurisë ndaj personit që ligjërisht prezumohet i pafajshëm, andaj Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë përcaktuar kritere rigorozë për të garantuar që masa e paraburgimit të mos cenoj të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë në aspektin juridik është i paqëndrueshëm dhe kontradiktor me vetë veten, arsyet e dhëna janë të pambështetura në prova dhe argumente por ndërtohen mbi hipoteza dhe formulime shabllonike, nuk ka vërtetuar fare dyshimin e bazuar sa i përket veprave penale, asnjëri nga kushtet të përcaktuara nga gjykata nuk plotësohen, ekzistimi i rrezikut për përsëritjen e veprës penale, ndikimi në dëshmitar arsyetohet në mënyrë të gabuar nga gjykata.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton dyshimi i bazuar se të pandehurit janë kryerës të veprave penale për të cilat dyshohen, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat tjera të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. të KPP, për vazhdimin e paraburgimit. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 191, paragrafi 1. lidhur me nenin 187, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurve në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se veprat penale për të cilat dyshohen janë të natyrës së rëndë, për të cilën, nëse të njëjtit shpallen fajtor, parashihet dënim mjaft i lartë, pastaj janë në moshë relativisht të re dhe nuk kanë ndonjë punë të rregullt dhe me gjetjen e tyre në liri të njëjtit do të mund të arratiset me

qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 191, paragrafi 1. lidhur me nenit 187, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2., pika 1.2.2. të KPP, sepse procedura e hetimeve është në fazën fillestare dhe duhet të grumbullohen provat materiale, duhet të dëgjohen nga ana e prokurorit të shtetit dëshmitarët/të dëmtuarit, prandaj ka arsye për të besuar se po të gjenden të pandehurit në liri ekziston rreziku se do të pengohet rrjedha normale e procedurës penale.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2., pika 1.2.3. të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, faktin se të pandehurit në vazhdimësi në mënyrë të fshehtë dhe të kundërligjshme kanë organizuar lojëra të fatit edhe përmes platformave online të cilat i kanë instaluar në telefonat e qytetarëve të moshave të ndryshme që të luajnë në lojëra të tilla, lë të besohet se ekziston rreziku se me qëndrimin e tyre në liri mund të përsërisin veprat penale apo ndonjë vepër tjetër të ngjashme penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.33/2023, më datë 30.01.2023

Bashkëpunëtoresh profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,  
Afrim Shala